UDHËZIM
Nr.15, datë 6.4.2011

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.5, DATË 18.2.2009 "PËR PËRMBAJTJEN DHE FORMËN E DIPLOMËS SË LËSHUAR NGA INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË"

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 26 dhe 31 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar

UDHËZOJ:

I. Në udhëzimin nr.5, datë 18.2.2009 "Për përmbajtjen dhe formën e diplomës së lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë", të bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

"2. Emërtimi i diplomës së lëshuar, sipas programeve të miratuara të studimit dhe cikleve të studimit, të jetë:

a) "Bachelor" në ... (fusha e arsimit të kryer);

b) "Master i shkencave" ose "Master i arteve të bukura" në... (fusha e arsimit të kryer)";

c) "Master profesional" në ... (fusha arsimit të kryer).

2. Pas shkronjës "l" të pikës 4, shtohet shkronja "m", si më poshtë:

"m. Formën e studimeve.".

3. Pas pikës 4 shtohen pikat 4.1 dhe 4.2, si më poshtë:

"4.1 Diploma universitare "Bachelor" e secilit student, duhet të përmbajë edhe ID e Maturës Shtetërore. Për studentët që kanë përfunduar shkollën e mesme përpara vitit 2006 të përdoret numri i regjistrit të veçantë të dëftesës së pjekurisë.

4.2 Diploma universitare Master i Shkencave ose Master Profesional e secilit student, duhet të përmbajë edhe numrin e diplomës së studimeve universitare të përfunduara më parë, përkatësisht studimeve të ciklit të parë (DNP), studimeve të integruara të niveli të dytë (DIND) ose studimeve universitare të sistemit të vjetër (Diplomë)."

II. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj